

Medverkan – Ndhimë për persona që përjetojnë dhunë në marrëdhënie të ngushta.

Medverkan është një projekt i përbashkët i katër komunave: Gislaved, Gnosjö, Vaggeryd dhe Värnamo. Projekti është bërë për shkak se Qeveria suedeze ka marrë një vendim i cili i obligon këto komuna që të marrin më shumë përgjegjësi rreth dhunës që ushtrohet kundër personave në marrëdhënie të ngushta. Ky projekt vlen edhe për fëmijët që jetojnë në familje që kanë raste të dhunës së tillë. Qëllimi i këtij projekti është që ky të jetë një shtesë/ndihmesë e punës së shërbimit social rreth ceshtjeve lidhur me dhunën kundër personave në marrëdhënie të ngushta. Por po ashtu një shtesë/ndihmesë edhe për organizatat idealiste në rajonin e GGVV-së të cilat punojnë me këto probleme sociale.

Medverkan është një projekt që ju drejtohet pikë së pari vajzave dhe grave të cilat janë të rrezikuara nga llojet e ndryshme të dhunës sic është dhuna fizike, psikjike, seksuale, kërcënim nga partneri i saj apo edhe nga dikush tjetër i njohur për viktimën.

Medverkan ofron:

- Sekret profesional
- Anonimitet sipas dëshirës
- Këshilla dhe mbështetje për vajza dhe gra që përjetojnë dhunë
- Ndhimë për fëmijët që jetojnë në familje ku ka dhunë të tillë
- Lidhje në mes aktorëve që merren me këto ceshtje në shoqëri. Sipas nevojës në bashkëpunim me polici, shërbimin social, vend strehimin e grave, instancën për viktima të krimeve, shërbimin mjekësor dhe sistemin e drejtësisë. Ne nuk bashkëpunojmë me dikë pa pëlqimin/lejen e klientit.
- Ndhimë për vajzat dhe gratë që përjetojnë dhunë lidhur me “nder” dhe “dinjitet”.
- Ndhimë dhe mbështetje për persona homoseksualë që jetojnë në marrëdhënie të dhunshme dhe ofrojmë po ashtu ndihmë për burra që përjetojnë dhunë në marrëdhënie të ngushta.
- Informacion për zyrtar dhe aktor tjerë që punojnë dhe janë në kontakt me persona që përjetojnë dhunë në marrëdhënie të ngushta.
- Kontribut me qëllim t'i parandalojmë dhunën në marrëdhënie të ngushta duke dhënë informata në instanca të ndryshme shtetërore (shkolla, shërbim mjekësor, shërbim social, shoqata të ndryshme etj.).

Takime me ne mund të mbani në katër komunitat: Gislaved, Gnosjö, Vaggeryd dhe Värnamo.

Në projektin **Medverkan** punojmë:

Valentina Hasi Tfn: 0370-331262

Sara Sand Tfn: 0370-331262

E-mail: medverkan@gnosjo.se

Adresa: Hellmansgatan 3, 335 30 Gnosjö

Kërkoni ndihmë urgjentisht nëse ju ose dikush i afërm i juaj përjeton dhunë dhe i nevojitet ndihmë. Mund të jetë një person që frikohet për jetë të vet ose është i frikësuar për fëmijët e vet e që janë në një situatë të vështirë .

Përveç ndihmës që mund të merrni në Medverkan, mund të drejtoheni edhe tek këto instanca:

Në raste urgjent telefono SOS alarm **122**

Polici (raste që janë më pak urgjente) **114 14**

Shërbimi social në Gislaved **0371-81120**

Shërbimi social në Gnosjö **0370-33 13 70**

Shërbimi social në Vaggeryd **0370-784 41**

Shërbimi social në Värnamo **0370-37 74 10**

Strehimi i grave MARIA në Gislaved **0371-809 86**

Strehimi i grave në Värnamo **0370-475 25**